



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 516/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet Rrahman Jakupi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimeve 2201X/04R në Shtime dhe 2202E/01R, Petrovë, për shkak të parregullsive në qendrat e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa A.nr.516/2021 e datës 15.02.2021, paraqitur nga deputeti Rrahman Jakupi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimeve 2201X/04R në Shtime dhe 2202E/01R, Petrovë, për shkak të parregullsive në qendrat e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.516/2021 e datës 15.02.2021, paraqitur nga deputeti Rrahman Jakupi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër komisionerëve të vendvotimeve 2201X/04R në Shtime dhe 2202E/01R, Petrovë në të cilën pretendohet se ka pasur shpërputhje të rezultatit në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve në vendvotimin 2201X/04R në Shtime, shkolla “Emin Duraku” ku dyshojnë se kandidati me nr. 41 Arben Fetoshi i janë bartur votat e tija – kandidatit Rrahman Jakupi dhe se nga raportimet e vëzhguesve votat e kandidatit me nr. 41 figurojnë si kandidatit Rrahman Jakupi dhe se është i bindur se janë vendosur gabim ngase i njëjti pretendon se ka shumë familjar dhe miq të cilët e kanë votuar në atë vendvotim, ndërsa i njëjti ka vetëm 1 votë. Ndërsa në vendvotimin 2202E/01R, Petrovë në shkollën “ Bajram Curri” ka konstatuar që në formularin e rezultateve të kandidatëve mund të jenë raportuar gabimisht ngase është shkruar jo qartë, e po ashtu thekson se nga raportimet e vëzhguesve i ka 113 vota ndërsa në FRK nuk vërehet qartë. Si dëshmi për këtë ankesës i ka bashkangjitur formularët e rezultatit të kandidatëve.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në qendrat e votimit në 2201X/04R në Shtime dhe 2202E/01R, Petrovë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së kandidatit për deputet Rrahman Jakupi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, hudhë si të pa lejueshme”* ankesa është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 516/2021 më datën 16.02.2021**

**Kryesues i Panelit
Zyhdë Haziri**



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 24 orë ne Gjykatën Supreme te Kosovës.*